



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

NJOFTIM
PËR MBLEDHJE PLENARE
20 TETOR 2023

Informacion mbi mbledhjen:

Dita/Data:	E premte, 20.10.2023
Ora:	10.00
Kohëzgjatja:	~ 120 min
Thirrur nga:	Kryetari i Këshillit
Pjesëmarrësit:	Anëtarët
Kuorumi i nevojshëm:	7 anëtarë

Kjo mbledhje do të organizohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit, në prezencë të Anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe të ftuar përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm dhe Programi OPDAT. Media si gjithmonë është e ftuar të jetë e pranishme.

Rendi i ditës:

1. Diskutimi/miratimi i procesverbalit të Seancës Plenare të datës 29.09.2023.
2. Diskutimi/ miratimi i projekt-aktit për “*Deklarimin e Mbarimit të statusit të magjistratit, për prokurorin. Bledar Mustafaraj*”.
3. Diskutimi/ miratimi i projekt-aktit për “*Deklarimin e Mbarimit të statusit të magjistratit, për prokuroren. Ollga Visi*”.
4. Diskutimi/ miratimi i projekt-aktit për “*Miratimin e dorëheqjes së z. Artur Cara nga pozicioni i Këshilltarit ligjor të Komanduar pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë*”.
5. Diskutimi/ miratimi i projekt-aktit për “*Plotësimin e një vakance në pozicionin prokurorit në prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele*”.
6. Diskutimi/ miratimi i projekt-aktit për “*Caktimin e përkohshëm në pozicionin e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm*”.
7. Diskutimi/ miratimi i projekt-aktit për “*Caktimin e përkohshëm në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër*”.
8. Diskutimi/ miratimi i projekt-aktit për “*Verifikimin e kushteve të kandidimit për vijimin e procedurave të ngritjes në detyrën e prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar*”.
9. Diskutimi/ miratimi i projekt-aktit “*Për shtimin e numrit të këshilltarëve magjistratë të komanduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë*”.

10. Diskutimi/miratimi i projekt-aktit mbi “Kërkesën e prokurorit **Kreshnik Ajazi** për ushtrim të veprimtarisë jashtë funksionit”.
11. Diskutimi/miratimi i projekt-aktit mbi “Kërkesën e prokurores **Marjeta Zaimi** për ushtrim të veprimtarisë jashtë funksionit”.
12. Diskutimi/miratimi i projekt-aktit mbi “Kërkesën e prokurores **Ornela Rrumbullaku** për ushtrim të veprimtarisë jashtë funksionit”.
13. Diskutimi/miratimi i projekt-aktit “Për Rishikimin e vendimit Nr.232, datë 16.09.2022, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, “Për ri-llogaritjen e pagave për anëtarët dhe ish-anëtarët e KLP-së, për periudhën 01.01.2019-28.05.2021”” .
14. Diskutimi/ miratimi i “Raportit për Analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit **Afrim Shehu**”.
15. Diskutimi/ miratimi i “Raportit për Analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit **Gentian Habazaj**”.
16. Diskutimi/ miratimi i “Raportit për Analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit **Olgert Rumnici**”.
17. Diskutimi/miratimi i projekt-aktit “Për verifikimin e pasurisë dhe figurës për prokurorin **Kreshnik Ajazi**, për efekt të rikandidimit në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, si dhe hedhja e shortit për caktimin e relatorit.”.
18. Diskutimi/miratimi i projekt-aktit “Për pranimin e kërkesave për vlerësim të përsheptuar për prokurorët **Erida Visoçi** dhe **Riselda Fishta**, në lidhje me procedurën e lëvizjes paralele shpallur me vendimin e KLP-së Nr.285, datë 17.07.2023”.
19. Diskutimi/ miratimi i Rregullores “Për caktimin e procedurës dhe masës së trajtimit financiar të prokurorit për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm, për caktimin e përkohshëm dhe caktimin për një çështje të veçantë”.
20. Diskutimi/ miratimi i Rregullores “Për organizimin dhe funksionimi e administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë”.

Të tjera (pyetje/diskutime).

Urdhërohet sektori i dokumentimit të seancave të bëj publikimin e kësaj axhende në faqen Web të Këshillit.

Njoftohen të gjithë anëtarët e Këshillit për të siguruar pjesëmarrjen

Kryetar
Alfred Balla